

PERSONI JURIDIK "HABILI" SH.P.K.

DREJTUAR: AKM-TIRANE
PER DIJENI: DRM-TIRANE
KAVAJE

LENDË: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

ID 3.1, e. "PERZIERJA E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT, PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODHIMI I BLOQEVE TË BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TE ÇIMENTOS (IMPIANT PER PRODHIM BETONI)"

DREJTUAR: AKM-TIRANE

SUBJEKTI : SUBJEKTI "HABILI" SH.P.K.

ADMINISTRATORI: Z.FATMIR HABILAJ

ADRESA : TIRANE, KAVAJE, LAGJA NR.4, RRUGA PRINC TOPIA, NDERTESE 1 KATESHE, ME ZONE KADASTRALE NR. 3427, NR. PASURIE 74/8, VOL.4,FQ 107

KAVAJE 2018

PERSONI JURIDIK "HABILI" SH.P.K.

Subjekti "HABILI" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.FATMIR HABILAJ merret me aktivitetin ID 3.1, e. Perzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos (Prodhimin dhe tregetimin e betonit me shumice dhe pakice)

Subjekti "HABILI" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.FATMIR HABILAJ ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja , ky subjekt duhet te aplikojte per leje mjedisi të tipit B.

SUBJEKTI : SUBJEKTI "HABILI" SH.P.K. ME NR. NIPTI K62505801B

ADMINISTRATORI: Z. FATMIR HABILAJ

ADRESA : TIRANE, KAVAJE, LAGJA NR.4, RRUGA PRINC TOPIA,
NDERTESE 1 KATESHE, ME ZONE KADASTRALE NR. 3427, NR.

PASURIE 74/8, VOL.4,FQ 107

Konform te te gjitha akteve dhe procedurave ligjore ne fuqi po i drejtohem AKM-Tirane per ndjeken e procedures konsultimit me publikun dhe palet e interesuara per aplikimin per LEJE MJEDISI TE TIPIT B.

Objekti ndodhet ne distanca te largeta nga qendrat e banuara si dhe aktiviteti ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Subjekti ka disa vite qe ushtron aktivitetin ne kete Impiant per prodhimin e betonit. Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Permiresimi urban i kesaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft te medha e te shpejta , urbanistike dinamike kohet e fundit vazhdon te terheq mjaft interesin e subjekteve privat si nje zone Industriale e bashkise Kavaje.

Hapsira para ndertesese se Impiant per prodhimin e betonit eshte e sistemuar , dekoruar me lule e lulishte duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor shume cilesor ,cka dhe ka ndikuar ne permiresimin e pamjes vizuale.

PERSONI JURIDIK "HABILI" SH.P.K.

Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit është një ndërtesë me hapësirën e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Duhet theksuar që subjekti ka disa vite që e ushtron këto aktivitete në këto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarresit që kanë aktivitetet pranë Aktivitetit Impiant për prodhimin e betonit.

Teritori i zgjedhur është mjaft i pershtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa përparësi si:

- Sistem perspektiv të furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korrekt të projektit
- Mundësi për ngritje të sistemit të kanalizimeve dhe shkarkimeve.
- Në afërsi të rrugës nacionale

Pozicioni i Impiant për prodhimin e betonit ka të zgjidhura disa nga problemet që lidhen me anën funksionale si.

- Largësi të mjaftueshme nga vendet e banuara.
- Pranë fuqisë punëtore.
- Zone Industriale

Sipërfaqja totale e truallit në Aktivitetin Impiant për prodhimin e betonit ku zhvillohet aktiviteti është 3940 m² e pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Kavaje dhe ka një kapacitet prodhues 49 m³ beton në ditë .

Veprimtaria e propozuar ushtrohet në Qarkun Tirane, Kavaje, Lagja Nr.4, Rruga Princ Topia, Ndertese 1 Kateshe, Bashkia Kavaje dhe ka qene e pajisur me Autorizim Mjedisore nga ARM-Tirane te vitit 2012 me PN-3265-04-2012.

Në të operojnë teknologjia dhe instalimet përkatëse, ambientet e shërbimeve mbështetëse dhe parkimi.

Teknologjia e Aktivitetit për prodhimin e betonit është teknologji e standarteve europiane prodhim Italian.

Aktiviteti Impiant për prodhimin e betonit është teresisht e mbyllur dhe me kontakte të për minimale.